



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.152

21 nëntor

2011

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.10 474 datë 27.10.2011	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve” 6975
Ligj nr.10 475 datë 27.10.2011	Për një ndryshim në ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”..... 6979
Dekret nr.7128 datë 21.10.2011	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 6980
Vendim i KM nr.709, datë 5.10.2011	Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e mësuesve dhe të nxënësve që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit..... 6980
Vendim i KM nr.712, datë 20.10.2011	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Bubq të qarkut të Durrësit..... 6982
Vendim i KM nr.714, datë 20.10.2011	Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit te Ministria e Drejtësisë, të sipërfaqes 46 266 m ² , në zonën kadastrale nr.8340, me numër pasurie 8/76, dhe për një ndryshim në vendimin nr.120, datë 4.3.2004 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit”..... 6983
Vendim i KM nr.717, datë 20.10.2011	Për transferimin e 100% të aksioneve të shoqërisë “Hec, Lanabregas” sh.a., Tiranë, të zotëruara nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, shoqërisë “Ujësjiellës-kanalizimeve” sh.a., Tiranë..... 6988

Vendim i KM nr.718, datë 20.10.2011	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor, Unaza e Madhe e Tiranës.....	6989
Vendim i KM nr.719, datë 20.10.2011	Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit, Sarandë.....	6994
Vendim i KM nr.720, datë 20.10.2011	Për disa shtesa në vendimin nr.37, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, në komunën Zapod të qarkut të Kukësit”, dhe për disa shtesa në vendimin nr.112, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në përdorim të njësisë së qeverisjes vendore komuna Zapod të qarkut të Kukësit”.....	6995
Vendim i KM nr.721, datë 20.10.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.902, datë 19.2.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Bradashesh të qarkut të Elbasanit”, dhe për disa ndryshime në vendimin nr.403, datë 8.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Bradashesh, të qarkut të Elbasanit”.....	6997
Vendim i KM nr.722, datë 20.10.2011	Për autorizimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit për të kryer veprimet e nevojshme për themelimin e qendrës “Protik”...	6999
Vendim i KM nr.725, datë 20.10.2011	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Qipros, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve.....	6999
Vendim i KM nr.728, datë 20.10.2011	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të ndërtimit dhe shfrytëzimit të portit të jahteve në Spille, Kavajë, dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet bashkimit të shoqërive “Çabej sh.p.k. dhe ABG, ndërtim sh.p.k.”.....	7006
Vendim i KM nr.731, datë 26.10.2011	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.....	7007
Vendim i KM nr.734, datë 26.10.2011	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Moglicë të qarkut të Korçës....	7008
Vendim i KM nr.736, datë 26.10.2011	Për uljen e tarifës së qirasë së mjediseve të Pallatit të Kongreseve, për organizimin e Panairit XIV të Librit, “Tirana 2011”.....	7009

Vendim i KM nr.737, datë 26.10.2011	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Vokopola 1” e “Vokopola 2” dhe miratimin e bonusit në procedurën për zgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë.....	7009
Vendim i KM nr.738, datë 26.10.2011	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentraleve mbi kaskadën e lumit Vjosa, si propozim i kërkuar.....	7010
Vendim i KM nr.739, datë 26.10.2011	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Kryeministrinë.....	7011
Vendim i KM nr.740, datë 26.10.2011	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të z. Drini Karagjozi.....	7011
Kërkesë e MPPT nr.4508/3, datë 21.10.2011	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga “Ndërtimi i linjave kryesore të dërgimit të sistemeve të kanalizimeve të ujërave të zeza të Lezhës dhe Shëngjinit për në ITUP e Qytetit të Lezhës”.....	7012
Kërkesë e METE nr.6464/1, datë 25.10.2011	Për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit tokë bujqësore, tokë truall, ndërtim, shtëpi banimi dhe “kulturave bujqësore” që preken nga “Ndërtimi dhe shfrytëzimi i linjës tregtare, me rrymë të vazhduar, të interkonjeksionit, Shqipëri-Itali”.....	7014
Kërkesë e METE nr.5379/5, datë 25.10.2011	Për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit tokë bujqësore, tokë truall, ndërtim, shtëpi banimi dhe “kulturave bujqësore” që preken nga “Ndërtimi i linjës ajrore të tensionit të lartë të parkut eolik”.....	7016
Kërkesë e MPPT nr.882/5, datë 26.10.2011	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Bulqizë-Ura e Cerenecit.....	7018

LIGJ
Nr.10 474, datë 27.10.2011

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË PËR
LËVIZJEN E NDËRSJELLË TË SHTETASVE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7153, datë 10.11.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË MBI LËVIZJEN E NDËRSJELLË TË SHTETASVE**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Serbisë (më poshtë të quajtura “Palët kontraktuese”), në emër të shteteve të tyre përkatëse:

të nisura nga dëshira për zgjerimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore ekzistuese ndërmjet të dyja vendeve;

duke konfirmuar se respektimi dhe zbatimi i të drejtave të njeriut, lirive themelore dhe parimeve të demokracisë, sundimit të ligjit dhe humanizmit përbëjnë bazën e lirisë, drejtësisë dhe paqes;

me synimin për të lehtësuar kontaktet ndërmjet popujve të tyre, si një mjet i rëndësishëm për forcimin e lidhjeve dhe mbështetjen e zhvillimit në të gjitha fushat e veprimtarive;

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Shtetasit e shteteve të secilës palë kontraktuese, mbajtës të dokumenteve të vlefshme të udhëtimit, të listuara në shtojcën I dhe II të kësaj marrëveshjeje përjashtohen nga detyrimi për pajisjen me vizë për hyrjen në territorin e palës tjetër kontraktuese, për një vizitë ose qëndrim që



nuk do të kalojë 90 (nëntëdhjetë) ditë brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes së tyre të parë.

2. Shtetasit e shteteve të secilës palë kontraktuese do të hyjnë, do të dalin dhe do të kalojnë transit në territorin e palës tjetër kontraktuese nëpërmjet pikave të kalimit kufitar të përcaktuara për qarkullim ndërkombëtar.

Neni 2

1. Shtetasit e shteteve të Palëve Kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit mund të hyjnë, të qëndrojnë, të kalojnë transit dhe të largohen nga territori i palës tjetër kontraktuese pa viza për një periudhë prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh brenda një periudhe 180 (njëqind e tetëdhjetë)-ditore nga data e hyrjes së tyre të parë.

2. Shtetasit e shteteve të secilës palë kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit, të cilët janë pjesëtarë të stafit të një misioni diplomatik ose posti konsullor, të një organizate ndërkombëtare, të një shërbimi tregtar dhe ekonomik, brenda misionit diplomatik ose të një qendre të informimit kulturor, të ngritura mbi bazën e një marrëveshjeje ndërqeveritare, të cilat ndodhen në territorin e palës tjetër kontraktuese, fillimisht do të hyjnë në territorin e saj pa viza dhe pas njoftimit, në përputhje me procedurat e brendshme të palës kontraktuese pritëse. Ata do të qëndrojnë dhe largohen nga territori i palës tjetër kontraktuese pritëse pa viza gjatë gjithë periudhës së akreditimit të tyre.

3. Dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni do të shtrihen edhe te pjesëtarët e familjes së shtetasve në fjalë: bashkëshortëve, fëmijëve nën moshën 26 vjeç, të cilët nuk kanë lidhur martesë civile dhe që frekuentojnë me kohë të plotë institucionet arsimore në territorin e palës tjetër kontraktuese, të cilët jetojnë së bashku me ta gjatë mandatit.

4. Dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni nuk do të zbatohen ndaj personave që mbulon paragrafi 3, kur këta janë qytetarë të një shteti të tretë, ndaj të cilit palët kontraktuese zbatojnë regjim vizash. Në këtë rast, personat në fjalë do të kenë llojin përkatës të vizës kur të mbërrijnë për herë të parë në territorin e palës kontraktuese pritëse.

Neni 3

Shtetasit e shteteve të secilës palë kontraktuese që dëshirojnë të qëndrojnë për një periudhë më të gjatë kohe në territorin e palës tjetër kontraktuese për qëllime studimi, punësimi, ribashkimi familjar etj., do t'u referohen dhe do t'u përmbahen dispozitave të legjislacionit të brendshëm të palës tjetër kontraktuese.

Neni 4

Në rast se për shkaqe të forcës madhore, një shtetas nuk mund të largohet nga territori i palës tjetër kontraktuese brenda periudhës së vlefshmërisë së qëndrimit të tij, shtyrja e qëndrimit do të rregullohet falas nga pala pritëse kontraktuese.

Neni 5

Shtetasit e secilës palë kontraktuese me afate të shkurtra qëndrimi në territorin e palës tjetër kontraktuese nuk kanë të drejtë punësimi.

Neni 6

Gjatë qëndrimit në territorin e palës tjetër kontraktuese, shtetasit e secilës palë kontraktuese do t'i përmbahen legjislacionit në fuqi.

Neni 7

Secila palë kontraktuese mund t'i mohojë hyrjen ose t'i japë fund qëndrimit në territorin e saj shtetasve të palës tjetër kontraktuese, të cilët sipas gjykimit të saj dhe në përputhje me legjislacionin e saj të brendshëm, janë të papranueshëm ose të padëshirueshëm.

Neni 8

Shtetasit e njërës palë kontraktuese, të cilët gjatë qëndrimit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese humbasin pasaportën ose një dokument tjetër zëvendësues udhëtimi, duhet të njoftojnë menjëherë për një rast të tillë autoritetet përkatëse vendore, të cilat do të lëshojnë një dokument ndihmës njoftimi. Misioni diplomatik ose posti konsullor përkatës i vendit, shtetas të të cilit ata janë do t'i pajisë ata me një dokument të ri të përshtatshëm. Dokumenti i ri i udhëtimit dhe i njoftimit duhet të tregohen në pikat e kalimit kufitar.

Neni 9

1. Palët kontraktuese do të shkëmbejnë nëpërmjet kanaleve diplomatike mostrat e dokumenteve të tyre të vlefshme të udhëtimit, jo më vonë se brenda 30 (tridhjetë) ditëve përpara hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

2. Kur njëra nga palët kontraktuese nxjerr një model të ri dokumenti udhëtimi ose modifikon dokumentet e shkëmbyera, pala tjetër kontraktuese do të njoftohet për këto ndryshime nëpërmjet kanaleve diplomatike 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së vënies në qarkullim të dokumentit të ri ose kryerjes së modifikimit. Njoftimit do t'i bashkëlidhet edhe një mostër e dokumentit të ri ose atij të modifikuar, si dhe informacione mbi zbatueshmërinë e tyre.

Neni 10

Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin gjatë zbatimit të dispozitave të kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen nëpërmjet konsultimeve ose kanaleve diplomatike.

Neni 11

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e të dyja palëve kontraktuese. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi në përputhje me nenin 13, paragrafi 1 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 12

1. Secila nga palët kontraktuese mund të pezullojë, tërësisht ose pjesërisht, zbatimin e kësaj marrëveshjeje me rastin e një katastrofe natyrore, epidemisë ose për arsye të sigurisë kombëtare dhe rendit publik, duke njoftuar menjëherë palën tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Pezullimi i zbatimit të kësaj marrëveshjeje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit përkatës.



2. Pala kontraktuese që ka ndërmarrë masën e treguar në paragrafin 1 të këtij neni, do të njoftojë menjëherë për anulimin e saj palën tjetër kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 13

1. Kjo marrëveshje do të jetë e vlefshme për një afat të pacaktuar kohe dhe do të hyjë në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet të cilit palët kontraktuese kanë njoftuar njëra-tjetrën me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike lidhur me plotësimin e kërkesave të tyre të brendshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

2. Secila nga palët kontraktuese mund të përfundojë vlefshmërinë e kësaj marrëveshjeje ose një pjesë të saj, duke njoftuar Palën tjetër Kontraktuese me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast, marrëveshja ose një pjesë e saj do të humbasë vlefshmërinë 90 (nëntëdhjetë) ditë pas datës së marrjes së këtij njoftimi.

3. Me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje, pushojnë të gjitha efektet e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federative të Jugosllavisë mbi heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, e nënshkruar më 26 nëntor 2002.

Bërë në Tiranë, më 5 korrik 2011, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqip, serbisht dhe anglisht, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë. Në rast se do të nevojitet interpretim, përparësi do të ketë teksti anglisht.

SHTOJCA I

Në listën e dokumenteve të vlefshme të udhëtimit për shtetasit e Republikës së Shqipërisë, për qëllime të kësaj marrëveshjeje, do të konsiderohen:

- a) pasaportë;
- b) pasaportë diplomatike;
- c) pasaportë shërbimi;
- d) dokument i vlefshëm udhëtimi për kthim në Republikën e Shqipërisë.

SHTOJCA II

Në listën e dokumenteve të vlefshme të udhëtimit për shtetasit e Republikës së Serbisë, për qëllime të kësaj marrëveshjeje, do të konsiderohen:

- a) pasaportë;
- b) pasaportë diplomatike;
- c) pasaportë shërbimi;
- d) leje kalimi.

LIGJ
Nr.10 475, datë 27.10.2011

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9901, DATË 14.4.2008 “PËR TREGTARËT DHE
SHOQËRITË TREGTARE”¹**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Në nenin 107, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Shoqëria aksionare me ofertë private nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 3 500 000 lekë.”.

Neni 2

Në nenin 187, në fund të pikës 1 shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) kur kapitali i shoqërisë aksionare bie nën minimumin ligjor të kërkuar nga neni 107 i këtij ligji.”.

Neni 3

Shoqëritë aksionare ekzistuese, me ofertë private, që janë themeluar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të detyruara të përfundojnë procedurat për regjistrimin e rritjes së kapitalit, të paktën deri në shumën e përcaktuar sipas nenit 1 të këtij ligji, brenda 1 viti pas hyrjes në fuqi të tij.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7154, datë 10.11.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

¹ Ky ligj është përafruar plotësisht me Direktivën e Dytë të Këshillit 77/91/KEE, datë 13 dhjetor 1976 “Mbi koordinimin e masave mbrojtëse nga shtetet anëtare, të cilat nevojiten për ruajtjen e interesave të anëtarëve dhe të tjerëve, për kompanitë, sipas kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 58 të Traktatit, lidhur me krijimin e shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuar, mbajtjen dhe ndryshimin e kapitalit të tyre, me qëllim për t’i bërë këto masa mbrojtëse ekuivalente”. Numri CELEX: 31977L0091, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 26, datë 31.1.1997, faqe 1-13.



DEKRET
Nr.7128, datë 21.10.2011

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe të nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 14, 20 dhe 24 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Fatbardha Mustafa Shehu
2. Ilban Ilir Shehu
3. Loreta Ilir Shehu
4. Arben Vehap Qoku
5. Koço Mitro Hila
6. Mitro Koço Hila
7. Mantha Jani Hila
8. Napolon Ukë Cami
9. Shqiponja Miftar Cami (Ndreu)
10. Liri Napolon Braha (Cami)
11. Elvis Lifter Pazaj
12. Edmond Qazim Xhamaqi
13. Selvi Faik Xhamaqi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.709, datë 5.10.2011

**PËR PËRDORIMIN E FONDEVE PUBLIKE PËR TRANSPORTIMIN E MËSUESVE DHE
TË NXËNËSVE QË PUNOJNË E MËSOJNË JASHTË VENDBANIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të kreut II të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportin rrugor”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpenzimet për transportin e mësuesve që punojnë jashtë qendrave urbane, larg vendbanimit të përhershëm të tyre, në distancën mbi 5 km, dhe kthehen brenda ditës, si dhe shpenzimet për transportin e nxënësve që ndjekin arsimin bazë larg vendbanimit, në distancën mbi 2 km, të përballohen nga fondet publike.

2. Drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore realizojnë procedurat e prokurimit për shërbimin e transportit të mësuesve dhe nxënësve vetëm në raste të mungesës së linjave qytetase apo linjave rrethqytetase të shërbimit të transportit publik, të licencuara në bazë qarku nga njësitë e qeverisjes vendore/qendrore.

3. Drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore, mbështetur në numrin e mësuesve dhe nxënësve që planifikohen të përfitojnë nga shërbimi i transportit, në bashkëpunim me këshillat e qarqeve, njësitë e qeverisjes vendore dhe Shoqatën e Transportit Publik, miratojnë hartën e linjave, sipas distancave të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Fondet publike për shërbimin e transportit prokurohen nga çdo drejtori arsimore rajonale dhe zyrë arsimore, në mbështetje të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

5. Për rastet kur drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore nuk sigurojnë/realizojnë procedurat e prokurimit publik për shërbimin e transportit të mësuesve dhe nxënësve, për mungesë konkurrence, masa e shpërblimit që përfitojnë mësuesit dhe nxënësit përcaktohet në raport me largësinë dhe kategorinë e rrugës, çmimin mesatar të biletës për linjat rrethqytetase, të miratuara nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, si dhe indeksimin e çmimeve të shërbimit të transportit, të botuar nga INSTAT-i.

Në këtë rast, pagesa për përfituesit, mësuesit dhe nxënësit realizohet nëpërmjet zyrave të Postës Shqiptare ose bankave të nivelit të dytë, por në asnjë rast nuk lejohen pagesa të drejtpërdrejta nga arka e drejtorive arsimore rajonale dhe zyrave arsimore.

6. Mësuesit që përfitojnë transport të siguruar nga drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore, sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, nuk përfitojnë shpërblim mujor për largësi nga vendbanimi i tyre, sipas vendimit nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar, kur distanca është më pak se 10 km. Kur kjo largësi është nga 10 deri 20 km, përfitojnë 1 000 (një mijë) lekë në muaj, ndërsa kur kjo distancë është mbi 20 km, përfitojnë 1800 (një mijë e tetëqind) lekë në muaj.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

8. Vendimi nr.486, datë 8.4.2008 i Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondeve buxhetore për transportin e mësuesve dhe nxënësve që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit”, shfuqizohet.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave, njësitë e qeverisjes vendore, këshillat e qarqeve, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr.712, datë 20.10.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS BUBQ, TË QARKUT TË DURRËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Bubq, të qarkut të Durrësit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Bubq, të qarkut të Durrësit, miratuar me vendimin nr.31, datë 23.9.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Bubq, të qarkut të Durrësit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Bubq për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Bubq, Durrës

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
162-171	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
172-177	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
179-182, 184,186-189, 191-193, 195-202	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
183, 185,190, 194, 209, 214, 219, 224, 227, 232 (vetëm kanale të treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi

VENDIM
Nr.714, datë 20.10.2011

PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT TE MINISTRIA E DREJTËSISË, TË SIPËRFAQES 46 266 M², NË ZONËN KADASTRALE NR.8340, ME NUMËR PASURIE 8/76, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.120, DATË 4.3.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit te Ministria e Drejtësisë, të pronës së paluajtshme, me sipërfaqe 46 266 (dyzet e gjashtë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) m², në zonën kadastrale nr.8340, me numër pasurie 8/76, me emërtim “Stacion hekurudhor, Tiranë”, e përcaktuar në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr.120, datë 4.3.2004 të Këshillit të Ministrave, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi, për ndërtimin e Pallatit të Drejtësisë.


2. Sipërfaqja 46 266 (dyzet e gjashtë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) m², përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.120, datë 4.3.2004 të Këshillit të Ministrave.

3. Ndalohen tjetërsimi, dhënia në përdorim apo ndryshimi i destinacionit të pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(TË TIPIT TË PRONAVE QË INVENTARIZOHEN SI KLASA TË VEÇANTA) LINJA TË DYTA NË STACIONE

Institucioni i Pushtetit Qendror: Ministria e Transporteve e Telekomunikacionit						Identifikoi: Drejtoria e Infrastruktures te D.P Hekurudhave					
Bashkia/Komuna: Sipas Specifikimeve te Vendndodhjes						Supervizoi: Dep.Teknik dhe Investimeve te D.P Hekurudhave					
Fusha e perdorimit te Prones: Transporti Hekurudhor						Aprovoi: Drejtori i Pergjithshem (Leonard Jani)					

A			B				C			
Nr. Rend	Zona Kadastr. Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e Prones Vend ndodhja/ Shtrirja Gjeografike Rrethi	Komponentet perberes te Prones	Adresa/ Vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e Prones ne m2	Funksioni per te perdoret Prona	Institucion/Ent me pergjegjesi administrative	Institucion/ Ent perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
3			Tirane	Linja te dyta km 5.12 Nderruese cope 25	Stacioni Tirane 36+650-37+150	96250	Transport Hekurudhor	Ministria e Transportit e Telekomunikac. D.P.Hekurudhave	Rajoni Tirane	
				Linja te dyta km 2.51 Nderruese cope 4	Stacioni Yzberisht 67+540-68+380	3400	"	"	"	
				Linja te dyta km 2.04 Nderruese cope 10	Stacioni Kashar 30+100-29+300	25500	"	"	"	
				Linja te dyta Km 5.47 Nderruese cope 21	Stacioni Vore 20+470-19+470	45955	"	"	"	
			Durrës	Linja te dyta km 2.06 Nderruese cope 6	Stacioni Sëkth 11+500-10+850	24470	"	"	Rajoni Durrës	
				Linja te dyta 4.43 Nderruese cope 34	Stacioni Shkozë - 1+800 - 0+600	197 133	"	"	"	



FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(TË TIPIT TË PRONAVE QË INVENTARIZOHEN SI KLASA TË VEÇANTA) STACIONET HEKURUDHORE

Institucioni i Pushtetit Qendror: Ministria e Transporteve e Telekomunikacionit						Identifikoi: Rajonet Hekurudhore te D.P.Hekurudhave				
Bashkia/Komuna: Sipas Specifikimeve te Vendndodhjes						Supervizoi: Dep.Teknik dhe Investimeve te D.P.Hekurudhave				
Fusha e perdorimit te Prones: Transporti Hekurudhor						Aprovoi Drejtori i Pergjithshem (Leonard Jani) <i>Leonard Jani</i>				
A			B				C			
Nr. Rend	Zona Kadastr. Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e Prones Vend ndodhja/ Shtirja Gjeografike Rrethi	Komponentet perberes te Prones	Adresa/ Vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e Prones ne m2	Funksioni per te perdoret Prona	Institucion/Ent me pergjegjesi administrative	Institucion/ Ent perdorues Statusi juridik i perdorimit	Siperfaqja totale e truallit m2
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
			Stacioni Tirane		Km 36+650-km 37+ 150		Transport Hekurudhor	Ministria e Transportit e Telekomunikac. D.P.Hekurudhave	Rajoni Tirane	96520
				Godina e stacionit		866	"	"	"	
				Administrata		182	"	"	"	
				Depo mallrash te ndryshme		144	"	"	"	
				Magazina Nr.1		660	"	"	"	
				Magazina Nr.2		900	"	"	"	
				Magazina Nr.3		1050.0	"	"	"	
				Magazina Nr.4		1080	"	"	"	
				Magazina Nr.5		325	"	"	"	
				Peshore auto		48	"	"	"	
				Kabine elektrike		18	"	"	"	
				Godina km 32		32	"	"	"	
				Reparte te ndryshme		238	"	"	"	
				Kulla e komandimit		9	"	"	"	

FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(TË TIPIT TË PRONAVE QË INVENTARIZOHEN SI KLASA TË VEÇANTA) OBJEKTE NË STACIONE

Institucioni i Pushtetit Qendror: Ministria e Transporteve e Telekomunikacionit Identifikoi Rajonet Hekurudhore te D.P.Hekurudhave

Bashkia/Komuna: Sipas Specifikimeve te Vendndodhjes Supervizoi: Dep.Teknik dhe Investimeve te D.P.Hekurudhave

Fusha e perdorimit te Prones: Transporti Hekurudhor Aprovoi:Drejtori i Pergjithshem (Leonard Jani)

A			B				C			
Nr. Rend	Zona Kadastr. Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e Prones Vend ndodhja/ Shtrirja Gjeografike Rrethi	Komponentet perberes te Prones	Adresa/ Vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e Prones ne m2 ose ml	Funksioni per te perdoret Prona	Institucion/Ent me pergjegjesi administrative	Institucion/ Ent perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te shena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
			Stacioni Hekurudhor Tirane		Km 36+650- km 37+150		Transport Hekurudhor	Ministria e Transportit e Telekomunikac. D.P.Hekurudhave	Rajoni Tirane	
				Peroni		1800 m2	"	"	"	
				Rrethimi		1740 ml	"	"	"	
				Shesh i Betonuar		12390 m2	"	"	"	
				Estakade		70ml	"	"	"	
				Sheshi i Estakades		2000 m2	"	"	"	
				Sheshi Asfaltuar		-	"	"	"	
				Rruge		6500 m2	"	"	"	
				Linja vinçi		100 ml	"	"	"	
				Linja te dyta		40960 m2	"	"	"	
				Furnizim energji		1100 ml	"	"	"	
				Furnizim me uje		150 ml	"	"	"	
				Sheshi para godines se udhetareve		2750 m2	"	"	"	
				Sheshi i bunkereve		-	"	"	"	



VENDIM
Nr.717, datë 20.10.2011

**PËR TRANSFERIMIN E 100% TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË “HEC”, LANABREGAS”
SHA, TIRANË, TË ZOTËRUARA NGA MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS, SHOQËRISË “UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE” SHA, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 2 të aktit normativ nr.4, datë 9.7.2008 “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros të këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr.9967, datë 24.7.2008, të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, të ligjit nr.8482, datë 10.5.1999 “Për një shtesë në ligjin nr.8237, datë 1.9.1997 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjitë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ligjit nr.10 430, datë 9.6.2011 “Për krijimin e shoqërive “HEC, Ulëz - Shkopet” sh.a., “HEC, Tiranë, Lanabregas” sh.a. dhe “HEC, Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a., dhe përcaktimin e formës e të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive “HEC, Ulëz-Shkopet” sh.a. dhe “HEC, Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a.”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e 100% të aksioneve të shoqërisë “HEC, Lanabregas” sh.a., Tiranë, me aksionar të vetëm Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, shoqërisë “Ujësjellës-kanalizimeve” sh.a., Tiranë.
 2. Transferimi i aksioneve do të bëhet me anën e kontratës së shitblerjes, sipas dispozitave të Kodit Civil.
 3. Vlera e transferimit të 100% të aksioneve të përcaktohet me ekspertë vlerësues dhe kontabël të autorizuar, të licencuar, dhe miratohet nga Ministri i Financave dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Pagesa e kësaj pakete të aksioneve të bëhet me lekë.
 4. Caktimi i ekspertëve, të përmendur në pikën 3 të këtij vendimi, bëhet me urdhër të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
 5. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “HEC, Lanabregas” sh.a., Tiranë, nuk ndryshon edhe pas kryerjes së këtij transferimi.
 6. Të ardhurat e realizuara nga transferimi i aksioneve derdhen në Buxhetin e Shtetit.
 7. Pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, ngarkohet shoqëria “Ujësjellës-kanalizime” sh.a., Tiranë, të kryejë procedurat përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe në shoqërinë “Qendra e Regjistrimit të Aksioneve” sh.a., Tiranë.
 8. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave, shoqëria “Ujësjellës-kanalizime” sh.a., Tiranë, shoqëria “HEC, Lanabregas” sh.a., Tiranë, Qendra Kombëtare e Regjistrimit, dhe shoqëria “Qendra e Regjistrimit të Aksioneve” sh.a., Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.718, datë 20.10.2011

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR, UNAZA E MADHE E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Unaza e Madhe e Tiranës.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 16 978 (gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë) m², me vlerë 44 519 117.37 (dyzet e katër milionë e pesëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë pikë tridhjetë e shtatë) lekë, dhe për objekte, me vlerë 24 323 494 (njëzet e katër milionë e treqind e njëzet e tre mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 68 842 611.37 (gjashtëdhjetë e tetë milionë e tetëqind e dyzet e dy mijë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë pikë tridhjetë e shtatë) lekësh.
4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 68 842 611.37 (gjashtëdhjetë e tetë milionë e tetëqind e dyzet e dy mijë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë pikë tridhjetë e shtatë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2011 “zëri investime”, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit.
6. Shpronësimi të fillojë më 30.10.2011 dhe të përfundojë më 30.12.2011.
7. Pronarët e objekteve të ndodhura në zonën kadastrale 8270, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja “Kufizohet deri në rregullimin e marrëdhënieve me truallin””, të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të jetë hequr kufizimi përkatës, si dhe në bazë të dokumentacionit të rifreskuar të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
8. Për objektet e ndodhura në zonën kadastrale 8280, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja “Zona në procesin e futjes në sistem/kufizim””, pronarët përkatës të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar procesi i futjes së zonës në sistem, heqjes së kufizimit përkatës, si dhe në bazë të dokumentacionit të rifreskuar të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
9. Për objektet, të cilat janë në proces legalizimi, pronarët përkatës të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar procesi i legalizimit, i regjistrimit pranë ZVRPP-së, Tiranë, si dhe në bazë të dokumentacionit të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
10. Pronarët e pasurive, tokë, për të cilat në kolonën përkatëse është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të rifreskuar të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.



11. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, për pronarët e objekteve të ndodhura në zonën kadastrale 8280, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja “Zona në procesin e futjes në sistem/kufizim””, pasi të përfundojë procesi i futjes në sistem i kësaj zone dhe pasi të hiqet kufizimi përkatës, fakt i cili do të konfirmohet zyrtarisht nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, së bashku me titujt e pronësisë, si dhe në bazë të dokumentacionit të rifreskuar, që do të dorëzojnë pronarët.

12. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, për pronarët e objekteve të ndodhura në zonën kadastrale 8270, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja “Kufizohet deri në rregullimin e marrëdhënieve me truallin””, pasi të jetë hequr kufizimi përkatës, fakt i cili të konfirmohet zyrtarisht nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, së bashku me titujt e pronësisë, si dhe në bazë të dokumentacionit të rifreskuar, që do të dorëzojnë pronarët.

13. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të likujdojë pronarët e pasurive, tokë, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja” dhe pronarët e “objekteve në proces legalizimi”, sipas pikave 9 dhe 10 të këtij vendimi.

14. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

15. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

16. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

OBJEKTET QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË AKSIT “UNAZA TIRANË”

Lloji i pasurisë së paluajtshme: objekte

Nr.	Pronari		ZK	NR.PAS	Vlera ne leke Sipas preventivit	EMERTIMI	Shenim
	Emri	Mbiemri				OBJEKTEVE	
1	KUJTIM + LULJETA	BRARI	8280		8,400,149	Lokal	Konfirmuar nga ZVRPP "zona ne procesin e futjes ne sistem" / "Kufizim"
2	ADELINA	GJUZJA	8270	8/138/ND	1,167,395	Lokal	Konfirmuar nga ZVRPP "Kufizohet deri ne rregullimin e marredhenieve me truallin"
3	AGRON	PETI	8280		13,458,759	Lokal	Konfirmuar nga ZVRPP "zona ne procesin e futjes ne sistem" / "Kufizim"/ Shtesa e objektit ne proces legalizimi
4	MAHMUT	BRAHJA	3266		1,297,191	Zdruktari	Proces Legalizimi
		TOTALI			24,323,494		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR “UNAZA E MADHE E TIRANËS”

NR	PRONARI			Z.K	NR PAS	NOMENKLATURA	SIP M2	CMIMI LEKE/M2	VLERA TOTALE LEKE	SHENIME
	EMER	ATESI	MBIEMER							
1	HALIL		BRAHJA	3266	84/2/1	K-34-100-(27-B)	1009	2622.165	2645764.485	Konfirmuar nga ZVRPP
2	ALUSH		BRAHJA	3266	84/4	K-34-100-(27-B)	805	2622.165	2110842.825	Konfirmuar nga ZVRPP
3	MALIQ	RESHIT	BRAHJA	3266	84/5	K-34-100-(27-B)	782	2622.165	2050533.03	Konfirmuar nga ZVRPP
4	FERAT	RESHIT	BRAHJA	3266	84/6	K-34-100-(27-B)	904	2622.165	2370437.16	Konfirmuar nga ZVRPP
5	SHYQYRI	RESHIT	BRAHJA	3266	84/7	K-34-100-(27-B)	985	2622.165	2582832.525	Konfirmuar nga ZVRPP
6	SAMI		BRAHJA	3266	86/7	K-34-100-(27-B)	250	2622.165	655541.25	Konfirmuar nga ZVRPP
7	ARBEN		BRAHJA	3266	86/8	K-34-100-(27-B)	250	2622.165	655541.25	Konfirmuar nga ZVRPP
8	ASTRIT	MEHMET	MUCA	3266	75/2/11	K-34-100-(27-B)	250	2622.165	655541.25	Konfirmuar nga ZVRPP
9	SABINA;ALTIN;GENCJAN		SARACI	3266	75/67	K-34-100-(27-B)	342	2622.165	896780.43	Konfirmuar nga ZVRPP
10	RITVAN; ZAMIRA		GJINI	3266	75/2/18	K-34-100-(27-B)	600	2622.165	1573299	Konfirmuar nga ZVRPP
11	RITVAN; ZAMIRA		GJINI	3266	75/68	K-34-100-(27-B)	137	2622.165	359236.605	Konfirmuar nga ZVRPP
12	HASAN	BAJRAM	KULICI	3266	75/77	K-34-100-(27-B)	24	2622.165	62931.96	Konfirmuar nga ZVRPP
13	SKENDER	ISMAIL	HARIZI	3266	75/80	K-34-100-(27-B)	500	2622.165	1311082.5	Konfirmuar nga ZVRPP
14	LULZIM	RAMAZAN	RAMA	3266	75/75	K-34-100-(27-B)	866	2622.165	2270794.89	Konfirmuar nga ZVRPP
15	SOSE	VESEL	BOSHNJAKU	3266	75/49	K-34-100-(27-B)	168	2622.165	440523.72	Konfirmuar nga ZVRPP
16	PERPARIM	SHYQYRI	HARIZI	3266	75/85	K-34-100-(27-B)	192	2622.165	503455.68	Konfirmuar nga ZVRPP
17	BUJAR		DOCI	3266	75/73	K-34-100-(27-B)	145	2622.165	380213.925	Konfirmuar nga ZVRPP
18	MEHMET	IMER	MEMIA	3266	75/86	K-34-100-(27-B)	233	2622.165	610964.445	Konfirmuar nga ZVRPP
19	PERPARIM	RAME	GABRAJ	3266	75/48	K-34-100-(27-B)	104	2622.165	272705.16	Konfirmuar nga ZVRPP
20	LEFTER	HASAN	LILA	3266	75/42	K-34-100-(27-B)	48	2622.165	125863.92	Konfirmuar nga ZVRPP
21	AGIME	KAJO	LILA	3266	75/65	K-34-100-(27-B)	42	2622.165	110130.93	Konfirmuar nga ZVRPP
22	BILBIL	MYDAR	VECANI	3266	75/82	K-34-100-(27-B)	328	2622.165	860070.12	Konfirmuar nga ZVRPP
23	MUAREM	VRENOS	ZANI	3266	75/87	K-34-100-(27-B)	2076	2622.165	5443614.54	Konfirmuar nga ZVRPP
24	KRESHNIK		BRAHJA	3266	75/38	K-34-100-(27-B)	380	2622.165	996422.7	Konfirmuar nga ZVRPP
25	ALI	SHEME	CAKONI	3266	75/2/42	K-34-100-(27-B)	500	2622.165	1311082.5	Konfirmuar nga ZVRPP
26	MIRASH	PREN	NDRECA	3266	75/2/43	K-34-100-(27-B)	395	2622.165	1035755.175	Konfirmuar nga ZVRPP
27	AHMET	RAMADAN	KOLICI	3266	75/2/44	K-34-100-(27-B)	120	2622.165	314659.8	Konfirmuar nga ZVRPP
28	ARJAN	ISMAIL	GOSTURJAN	3266	75/10	K-34-100-(27-B)	156	2622.165	409057.74	Konfirmuar nga ZVRPP
29	ENO	PAVLO	XIMXO	3266						

29	FERIT	REXHEP	LEKA	3266	75/28	K-34-100-(27-B)	600	2622.165	1573299	Konfirmuar nga ZVRPP
30	XHEVAIR	JONUZ	GJONI	3266	75/29	K-34-100-(27-B)	400	2622.165	1048866	Konfirmuar nga ZVRPP
31	SANIE	REXHEP	RECI	3266	75/16	K-34-100-(27-B)	400	2622.165	1048866	Konfirmuar nga ZVRPP
32	NEKI	IBRAHIM	ELEZI	3266	75/23	K-34-100-(27-B)	20	2622.165	52443.3	Konfirmuar nga ZVRPP
33	FONDACIONI "EL-FURKAN"			3266	73/3	K-34-100-(27-B)	870	2622.165	2281283.55	Konfirmuar nga ZVRPP
34	RRAHMAN	MYRTEZA	BRAHJA	3266	73/4	K-34-100-(27-B)	263	2622.165	689629.395	Konfirmuar nga ZVRPP
35	DALIP	ABAZ	BRAHJA	3266	162/2	K-34-100-(27-B)	800	2622.165	2097732	Konfirmuar nga ZVRPP
36	ENVER	BAJRAM	BRAHJA	3266	70/6	K-34-100-(27-B)	549	2622.165	1439568.585	Konfirmuar nga ZVRPP
37	SHAQIR	RRAHMAN	BRAHJA	3266	70/8	K-34-100-(27-B)	159	2622.165	416924.235	Konfirmuar nga ZVRPP
38	SHAQIR	RRAHMAN	BRAHJA	3266	70/9	K-34-100-(27-B)	326	2622.165	854825.79	Konfirmuar nga ZVRPP
	TOTALI						16978		44519117.37	



VENDIM
Nr.719, datë 20.10.2011

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË
SHËRBIMEVE TË MIDHJES DHE PESHKIMIT, SARANDË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkrirjen e Ndërmarrjes së Rritjes së Midhjes e Zënies së Peshkut, me qendër në Sarandë, e krijuar me vendimin nr.152, datë 8.4.1992 të Komitetit Ekzekutiv të rrethit Sarandë.
 2. Krijimin e Drejtorisë së Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit, si institucion publik me qendër në Sarandë, në varësi të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.
 3. Drejtoria e Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit drejtohet nga drejtori, i cili emërohet nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.
 4. Rekrutimi i punonjësve të Drejtorisë së Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit bëhet sipas procedurave të përcaktuara në Kodin e Punës.
 5. Drejtoria e Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit ka këto detyra:
 - a) Menaxhimin e Qendrës dhe Impianteve të Midhjes, në Sarandë;
 - b) Menaxhimin e porteve dhe qendrave të peshkimit në të gjithë territorin e vendit;
 - c) Menaxhimin e ekonomive të rasateve të peshkut, në Zvezdë, Korçë dhe të rasateve të koranit, në Lin, Pogradec;
 - ç) Grumbullimin e të dhënave statistikore të prodhimit të peshkut dhe molusqeve, si dhe të të dhënave social-ekonomike.
 6. Drejtoria e Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit harton rregulloren e vet të funksionimit, ku përcaktohen të drejtat, detyrat dhe përkrahjet e vendit të punës së çdo funksioni në këtë drejtori. Rregullorja miratohet nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.
 7. Veprimtaria e Drejtorisë së Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit të financohet nga buxheti i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.
 8. Struktura dhe organika e kësaj drejtorie miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozim të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.
 9. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për ndjekjen e procedurave në QKR, për çregjistrimin si person juridik të Ndërmarrjes së Rritjes së Midhjes e Zënies së Peshkut, me qendër në Sarandë.
 10. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.720, datë 20.10.2011

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.37, DATË 16.1.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, NË KOMUNËN ZAPOD TË QARKUT TË KUKËSIT”, DHE PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.112, DATË 3.2.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PËRDORIM TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE KOMUNA ZAPOD TË QARKUT TË KUKËSIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës shtesë të inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, pyje dhe kullota, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Zapod, të qarkut të Kukësit, që i bashkëlidhet vendimit nr.37, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave.

Lista shtesë me 1 (një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, fillon me numër inventari prone 243 dhe mbaron me numrin 259.

2. Miratimin e shtesës së listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore komuna Zapod, të qarkut të Kukësit, që do t'i transferohen në përdorim kësaj njësie, që i bashkëlidhet vendimit nr.112, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave.

Shtesa e listës përfundimtare me 5 (pesë) fletë, që fillon me numër inventari prone 110 dhe mbaron me numër 259, si dhe tabela me lidhjen nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Zapod për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Zapod

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
110-259	Pyll, kullotë, të tjera	Pronësi



2. FORMULAR PËR INVENTARIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE (LISTA SHITESË)
(MBËSHKETUR NË INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË VEÇANTA TË TIPIT PYJE, KULLOTA, LIVADHE, SHKËMBORE ETJ.)

Shefi Menaxhimit .Xhiman QEJVANI

Pergjegjesi Zyres Admin. Tokes ne komune /Meriman Avdyli

Kryetrai NJQV: Dan KOLOSHI

Nr.	Emertesa e Ekonomise	Emertesa e Ngastres	Numeri		Siperfaqia	Funksini	Institucioni	Institucioni	Te dhena
INVEN TARIT	Pyjore dhe Kullimore (EPK)	Vendndodhja(sipas emertesës popullore)	Ngastres	Destinacioni	ne ha	per te cilin perdoret prona	Enti me pergjegjesit administrative	enti perdorues statusi juridik i perdorimit	te tjera (Shenime te veçanta)
243	Shishtavec-Zapod	Livadhi Gem	5/b	Shkembore	40.43		MMPAU	D.Sh.P.	"
244	Shishtavec-Zapod	Livadhi Gem	5/c	Cveshur	8.99		MMPAU	D.Sh.P.	"
245	Shishtavec-Zapod	Livadhi Gem	6/a	pyll mbrojtës	9.98	kundra erozioni	MMPAU	D.Sh.P.	"
246	Shishtavec-Zapod	Koritniku	15/b	Shkembore	47.17		MMPAU	D.Sh.P.	"
247	Shishtavec-Zapod	Shap	45/b	Cveshur	31.06		MMPAU	D.Sh.P.	"
248	Shishtavec-Zapod	Vrancez	46/a	pyll prodhues	6.76	Dru Zjarri	MMPAU	D.Sh.P.	"
249	Shishtavec-Zapod	Teja e Koloshit	68/d	pyll mbrojtës	24.9	kundra erozioni	MMPAU	D.Sh.P.	"
250	Shishtavec-Zapod	"	137/a	pyll prodhues	10.25	Dru Zjarri	MMPAU	D.Sh.P.	"
251	Shishtavec-Zapod	"	137/b	bimesi pyjore	1.75		MMPAU	D.Sh.P.	"
252	Shishtavec-Zapod	Shifaki	139/a	pyll prodhues	23.94	Dru Zjarri	MMPAU	D.Sh.P.	"
253	Shishtavec-Zapod	Shpati I lopeve	139/b	pyll mbrojtës	23.19	kundra erozioni	MMPAU	D.Sh.P.	"
254	Shishtavec-Zapod	Shpati I lopeve	139/c	Cveshur	9.47		MMPAU	D.Sh.P.	"
255	Shishtavec-Zapod	Shpati I lopeve	139/d	Livadh	3.99	Kositje	MMPAU	D.Sh.P.	"
256	Shishtavec-Zapod	Shpati I lopeve	139/e	Shkembore	1.99		MMPAU	D.Sh.P.	"
257	Shishtavec-Zapod	Mali I Ziberit	140/a	pyll prodhues	50.37	Dru Zjarri	MMPAU	D.Sh.P.	"
258	Shishtavec-Zapod	Mali I Ziberit	140/c	Livadh	10.97	Kositje	MMPAU	D.Sh.P.	"
259	Shishtavec-Zapod	Mali I Ziberit	140/d	Cveshur	3.99		MMPAU	D.Sh.P.	"

VENDIM
Nr.721, datë 20.10.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.902, DATË 19.2.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË KOMUNËN BRADASHESH, TË QARKUT TË ELBASANIT” DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.403, DATË 8.4.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, KOMUNA BRADASHESH, TË QARKUT TË ELBASANIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e shtesave dhe pakësimeve në listën e inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, pyje dhe kullota, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Bradashesh të qarkut të Elbasanit, që i bashkëlidhet vendimin nr.902, datë 19.2.2007 të Këshillit të Ministrave, përkatësisht si vijon:

a) Lista shtesë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, është me 1 (një) fletë dhe fillon me numër prone 1909 e mbaron me numër 1915.

b) Lista pakësuese, që i bashkëlidhet këtij vendimi, është me 1 (një) fletë me numrat e pronave 727 dhe 776.

2. Miratimin e shtesave dhe pakësimeve në listën përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Bradashesh të qarkut të Elbasanit, që do t’i transferohen në përdorim kësaj njësie, që i bashkëlidhet vendimit nr.403, datë 8.4.2008 të Këshillit të Ministrave, përkatësisht si vijon.

a) Lista shtesë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, është me 3 (tri) fletë dhe mbaron me numër rendor 78.

b) Lista pakësuese, që i bashkëlidhet këtij vendimi, është me 1 (një) fletë dhe mbaron me numër rendor 1.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Bradashesh për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Bradashesh

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
640-679, 693-714, 717, 758-773, 1909-1915	Pyje, kullota dhe sipërfaqe me bimësi pyjore	Pronësi



2. FORMULAR PËR PAKËSIM NË INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË VEÇANTA TË TIPIT PYJE, KULLOTA, LIVADHE, SHKËMBORE ETJ.)

Miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.902, datë 19.2.2007

Bashkia komuna: Bradashesh Fusha e përdorimit të pronës: pyje dhe kullota									
Nr. rendor	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullorose (EPK)	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja sipas emërtesës popullore	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sip. ha	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/enti me përgjegjësi	Institucioni/enti me përdorues/statusi juridik	Të dhëna të tjera, shënime të veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
727	Ekonomia pyjore “Kushe 1”	Vidhet e Zallishtes	10	Shkurre	34	Prodhues	MMPAU	DSHP Elbasan	
776	Ekonomia pyjore “Kushe 1”	Shtëpia e Lekajve	32 a	Shkurre	26	Prodhues	MMPAU	DSHP Elbasan	
	Shuma								

VENDIM
Nr.722, datë 20.10.2011

PËR AUTORIZIMIN E MINISTRIT PËR INOVACIONIN DHE TEKNOLOGJINË E INFORMACIONIT E TË KOMUNIKIMIT PËR TË KRYER VEPRIMET E NEVOJSHME PËR THEMELIMIN E QENDRËS “PROTIK”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 11 të ligjit nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar, dhe të nenit 56 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të autorizojë Ministrin për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit:

- a) për të kryer procedurat ligjore për themelimin e qendrës “Protik”;
- b) për të përcaktuar kontributin e Qeverisë Shqiptare në qendrën “Protik”;
- c) për të caktuar përfaqësuesin e tij në bordin e kësaj qendre.

2. Ngarkohet Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.725, datë 20.10.2011

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË QIPROS, PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INVESTIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Qipros, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



MARRËVESHJE

MBI NXITJEN DHE MBROJTJEN RECIPROKE TË INVESTIMEVE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË QIPROS

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Qipros, këtu të quajtura “Palët Kontraktuese”,

me dëshirën për të intensifikuar bashkëpunimin ekonomik për përfitimin e përbashkët të të dyja vendeve,

duke synuar krijimin e kushteve të favorshme për investimet e bëra nga investitorët e secilës palë kontraktuese në territorin e palës tjetër kontraktuese, dhe

të ndërgjegjshëm që nxitja dhe mbrojtja e investimeve sipas kësaj marrëveshjeje stimulon iniciativat në këtë fushë,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1 Përkufizime

Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje:

1. Termi “investime” është çdo lloj sendi pasuror dhe veçanërisht, megjithëse jo në mënyrë përjashtuese, sa më poshtë:

a) pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme dhe çdo të drejtë tjetër pasurore, si hipotekat, pengjet, barrët dhe të drejta të tjera të ngjashme;

b) pjesët, aksionet dhe obligacionet, dhe çdo formë tjetër pjesëmarrjeje në një shoqëri ose ndërmarrje biznesi dhe të drejtat ose interesi i përfutur nga;

c) pretendimet monetare ose një përmbushje tjetër detyrimi sipas një kontrate që ka një vlerë ekonomike dhe të lidhur me një investim;

d) të drejtat e pronësisë intelektuale, duke përfshirë të drejtat në lidhje me të drejtat e autorit, patentat, markat tregtare, emrat tregtarë, dizenjot industriale, proceset teknike, të fshehtat tregtare dhe ekspertiza, dhe vullneti i mirë; dhe

e) të drejtat për të ndërmarrë aktivitete ekonomike të dhëna me ligj ose me kontratë, duke përfshirë koncesionet për kërkimin, kultivimin, nxjerrjen ose shfrytëzimin e burimeve natyrore.

Investimet e bëra në territorin e një pale kontraktuese nga një subjekt juridik i asaj pale kontraktuese, që faktikisht është në pronësi ose kontrollohet nga investitorët e palës tjetër kontraktuese, konsiderohen po ashtu si investime të kësaj pale kontraktuese nëse ato janë bërë në pajtim me ligjet dhe rregulloret e palës tjetër kontraktuese.

2. Termi “investitor” në lidhje me një palë kontraktuese janë:

a) personat fizikë që kanë shtetësinë e asaj pale kontraktuese në pajtim me ligjin e saj;

b) personat juridikë të formuar, themeluar ose regjistruar në pajtim me ligjin e asaj pale kontraktuese, duke përfshirë, korporatat, firmat, ortakëritë ose shoqatat e biznesit;

që në pajtim me këtë marrëveshje, po bëjnë investime në territorin e palës tjetër kontraktuese.

Çdo ndryshim në formën në të cilën investohen ose riinvestohen sendet pasurore, nuk ndikon karakterin e tyre si investime.

3. Termi “të ardhura” do të thotë shumat e dhëna nga një investim dhe përfshin veçanërisht, megjithëse jo përjashtimisht, fitimet, dividendët, interesin, fitimet kapitale, tarifatat e licencave dhe honorarët.

4. Termi “territor” përcakton:

a) në lidhje me territorin e Republikës së Shqipërisë është territori nën sovranitetin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë ujërat territoriale, si dhe zonën detare dhe shelfin kontinental mbi të cilin Republika e Shqipërisë, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme dhe të drejtën ndërkombëtare ushtron të drejtat sovrane dhe ligjore.

b) në lidhje me territorin e Republikës së Qipros, kur përdoret në kuptimin gjeografik, përfshin territorin kombëtar, detin territorial të saj, si dhe zonën jashtë detit territorial, duke përfshirë zonën e afërt, zonën ekonomike ekskluzive dhe shelfin kontinental, që është caktuar ose mund të caktohet, në bazë të ligjeve të Qipros dhe në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, si zonë brenda së cilës Qipro mund të ushtrojë të drejtat e saj sovrane të juridiksionit.

5. Termi “Këshilli i Ministrave”, në lidhje me Republikën e Shqipërisë, është “Qeveria e Republikës së Shqipërisë”.

Neni 2 Objekti

Kjo marrëveshje zbatohet për të gjitha investimet e bëra nga investitorët e një pale kontraktuese, ekzistuese ose të bëra pas hyrjes së saj në fuqi. Ajo megjithatë nuk mund të zbatohet për mosmarrëveshjet që kanë lindur para hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Neni 3 Nxitja dhe mbrojtja e investimeve

1. Secila palë kontraktuese inkurajon dhe krijon kushte të favorshme për investitorët e palës tjetër kontraktuese për të bërë investime në territorin e saj dhe i pranon këto investime në pajtim me ligjet dhe rregulloret e veta.

2. Nëse një palë kontraktuese ka pranuar një investim në territorin e saj, ajo, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e saj, jep lejet e nevojshme në lidhje me këtë investim dhe me përmbushjen e marrëveshjeve të licencimit dhe kontratat për asistencën teknike, tregtare ose administrative. Secila palë kontraktuese, kurdoherë të jetë e nevojshme, përpiqet të nxjerrë autorizimet e nevojshme në lidhje me aktivitetet e konsulentëve dhe personave të tjerë të kualifikuar, pavarësisht shtetësisë së tyre.

3. Investimet e bëra nga investitorët e një pale kontraktuese në territorin e palës tjetër kontraktuese marrin gjithmonë një trajtim të drejtë dhe të barabartë dhe gëzojnë mbrojtjen dhe sigurinë e plotë.

4. Asnjë palë kontraktuese nuk cenon me anë të masave të paarsyeshme ose diskriminuese menaxhimin, mirëmbajtjen, përdorimin, gëzimin, zgjerimin ose disponimin e këtyre investimeve.

5. Palët kontraktuese janë të përkushtuara të thjeshtojnë format dhe procedurat e procesit të nxitjes dhe mbrojtjes së investimit.

Neni 4 Trajtimi kombëtar dhe i kombit më të favorizuar

1. Nëse një palë kontraktuese ka pranuar një investim në territorin e saj në pajtim me ligjet dhe rregulloret e saj, ajo u jep këtyre investimeve të bëra nga investitorët e palës tjetër kontraktuese një trajtim jo më pak të favorshëm se ai që u jepet investimeve të investitorëve të vet ose investitorëve të një shteti të tretë, cilido të jetë më i favorshëm për investitorin përkatës.



2. Secila palë kontraktuese u jep investitorëve të palës tjetër kontraktuese në territorin e vet në lidhje me menaxhimin, mirëmbajtjen, përdorimin, gëzimin, zgjerimin ose disponimit të investimit të tyre, një trajtim jo më pak të favorshëm se ai që u jepet investitorëve të vet ose investitorëve të një shteti të tretë, cilido të jetë më i favorshëm për investitorin përkatës.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk interpretohen sikur detyrojnë një palë kontraktuese për t'u dhënë investitorëve të palës tjetër kontraktuese dhe investimeve të tyre përfitimin e një trajtimi, preference ose privilegji që rrjedh nga:

a) anëtarësia në një bashkim doganor ose ekonomik ekzistues ose të ardhshëm bashkim monetar ose një organizatë tjetër rajonale të integritit ekonomik; dhe

b) një marrëveshje ose masë ndërkombëtare që ka të bëjë tërësisht ose kryesisht me tatimet ose me një ligj të brendshëm që ka të bëjë tërësisht ose kryesisht me legjislacionin.

4. Trajtimi i përmendur në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni jepet mbi bazën e reciprocitetit.

5. Asgjë në këtë marrëveshje nuk mund të pengojë një palë kontraktuese nga zbatimi i masave të reja të miratuara në kuadrin e një prej formave të bashkëpunimit rajonal të përmendura në paragrafin 3 (a) të këtij neni që zëvendëson masat e zbatuara më parë nga ajo palë kontraktuese.

Neni 5 **Shpronësimi**

1. Investimet e investitorëve të një pale kontraktuese në territorin e palës tjetër kontraktuese nuk shtetëzohet, shpronësohet ose t'u nënshtrohet masave që kanë një efekt të barasvlershëm me shtetëzimin ose shpronësimin (këtu të quajtur "shpronësim") përveç interesit publik, në pajtim me procesin e drejtë, me një bazë jodiskriminuese dhe kundrejt një kompensimi të menjëhershëm, të drejtë dhe të efektshëm.

2. Ky kompensim është i barabartë me vlerën e drejtë të tregut të investimit të shpronësuar menjëherë para shpronësimit ose menjëherë para se shpronësimi të bëhet publik, cilido është më parë (këtu quhet "data e vlerësimit").

3. Kjo vlerë e tregut llogaritet në një monedhë lirisht të konvertueshme me vlerën e tregut të këmbimit që mbizotëron për atë monedhë në datën e vlerësimit. Kompensimi përfshin interesin e llogaritur në bazë të normës 6-mujore LIBOR të zbatueshme në datën e shpronësimit, nga data e shpronësimit deri në datën e pagesës. Kompensimi paguhet pa vonesë, është efektivisht i realizueshëm dhe lirisht i transferueshëm.

4. Investitori përkatës, në bazë të ligjit të shtetit kontraktues që bën shpronësimin, ka të drejtën e rishikimit të menjëhershëm nga një autoritet gjyqësor ose një autoritet tjetër kompetent dhe i pavarur i asaj pale kontraktuese të çështjes, duke përfshirë vlerësimin e investimeve të saj dhe pagesën e kompensimit, në pajtim me parimet e parashikuara në këtë nen.

5. Nëse një palë kontraktuese shpronëson sendet pasurore të një shoqërie që është themeluar ose krijuar në bazë të ligjit në fuqi në një pjesë të territorit të saj dhe në të cilën investitorët e palës tjetër kontraktuese kanë aksione, garanton që dispozitat e kësaj marrëveshjeje të zbatohen për të garantuar kompensim të menjëhershëm, të drejtë dhe të efektshëm në lidhje me investimet e tyre për këto investues të palës tjetër kontraktuese që janë pronarë të atyre aksioneve.

Neni 6 **Kompensimi për humbjet**

1. Investitorët e një pale kontraktuese, investimet e të cilëve në territorin e palës tjetër kontraktuese pësojnë humbje për shkak të luftës ose të konfliktit të armatosur, gjendjes së

emergjencës kombëtare, revolucionit, kryengritjes, trazirave publike ose një ngjarjeje të ngjashme, marrin nga kjo palë kontraktuese në lidhje me kthimin, zhdëmtimin, kompensimin ose një zgjidhje tjetër, një trajtim jo më pak të favorshëm se ai që kjo palë kontraktuese u jep investitorëve të vet ose investitorëve të një shteti të tretë, cilido qoftë më i favorshëm për investitorët përkatës. Pagesat përkatëse janë lirisht të transferueshme.

2. Pavarësisht paragrafit 1, një investitor i një pale kontraktuese që, në një nga situatat e përmendura në atë paragraf, pëson një humbje në territorin e palës tjetër kontraktuese që rrjedh nga:

- a) përfitimi i investimit ose një pjese të tij nga forcat ose autoritetet e tij; ose
- b) shkatërrimi i investimit ose i një pjese të tij nga forcat ose autoritetet, i cili nuk kërkohej nga domosdoshmëria e situatës, i sigurohet nga kjo palë kontraktuese kthimi ose kompensimi i cili në çdo rast është i menjëhershëm, i përshtatshëm dhe efektiv. Pagesat që rezultojnë bëhen pa vonesë dhe lirisht të transferueshme.

Neni 7 **Transfertat**

1. Secila palë kontraktuese u garanton investitorëve të palës tjetër kontraktuese transferimin e lirë të të gjitha pagesave në lidhje me investimet e tyre. Këto transfertat përfshijnë veçanërisht, megjithëse jo përjashtimisht:

- a) fitimin neto, fitimet nga kapitali, dividendët, interesin, licencat e tarifave, honorarët dhe çdo formë të fitimit faktik që rrjedh nga investimet;
- b) të ardhurat nga investimet, të përcaktuara në nenin 1;
- c) fondet për shlyerjen e huave në lidhje me investimet;
- d) kompensimet e parashikuara në nenet 5 dhe 6;
- e) shitjet nga shitja ose likuidimi i plotë ose i pjesshëm i një investimi;
- f) fitimet ose shpërblimet e tjera të personelit të përfshirë nga jashtë në lidhje me investimin;
- g) pagesat që rrjedhin nga zgjidhja e një mosmarrëveshjeje.

2. Transfertat sipas kësaj marrëveshjeje bëhen pa vonesë në një monedhë lirisht të konvertueshme me vlerën e tregut të këmbimit që mbizotëron në datën e transfertës.

3. Pavarësisht paragrafëve 1 dhe 2 më sipër, një palë kontraktuese mund të miratojë ose mbajë masa në lidhje me transaksionet ndërkufitare për kapitalin dhe pagesat të miratuara nga Komitetet Europiane dhe veçanërisht por pa u kufizuar në çështjet e mëposhtme:

- a) në rastin e balancës serioze të pagesave dhe vështirësive financiare të jashtme ose rrezikut për të; ose
- b) në rastet kur, në rrethana të veçanta, lëvizjet e kapitalit shkaktojnë ose rrezikojnë të shkaktojnë vështirësi serioze për menaxhimin makro-ekonomik, veçanërisht politikat e normave të këmbimit dhe monetare; ose

- c) në raste të veçanta të sanksioneve ekonomike.

4. Masat e përmendura në paragrafin 3 të këtij neni:

- a) nuk i tejkalojnë masat e nevojshme për të trajtuar rrethanat e parashikuara në paragrafin 3 të këtij neni;
- b) janë të përkohshme dhe mënjanojnë sapo të lejojnë rrethanat; dhe
- c) i njoftohen menjëherë palës tjetër kontraktuese.

Neni 8 **Termat më të favorshëm**

1. Nëse legjislacioni i një pale kontraktuese ose detyrimet ekzistuese sipas së drejtës ndërkombëtare ose të vendosura më vonë ndërmjet palëve kontraktuese, përveç kësaj marrëveshjeje



përmajnë një rregull, të përgjithshëm ose të veçantë, që u jep të drejtën investimeve të investitorëve të palës tjetër kontraktuese për një trajtim më të favorshëm se ai i parashikuar nga kjo marrëveshje, ky rregull, në masën që është më i favorshëm, mbizotëron mbi këtë marrëveshje.

2. Kushtet më të favorshme se ato të kësaj marrëveshjeje, për të cilat është rënë dakord nga një prej palëve kontraktuese me investitorët e palës tjetër kontraktuese, nuk ndikohen nga kjo marrëveshje.

Neni 9 Zëvendësimi

1. Nëse një palë kontraktuese ose agjencia e caktuar prej saj bën një pagesë për investitorët e saj në bazë të një garancie ose kompensimi të dhënë në lidhje me investimet në territorin e shtetit të palës tjetër kontraktuese, kjo palë kontraktuese njeh:

a) cedimin, në bazë të ligjit ose në pajtim me një veprim juridik në atë shtet, të çdo të drejte ose pretendimi nga investitorët tek pala tjetër kontraktuese ose agjencia e caktuar prej saj; dhe

b) që pala tjetër kontraktuese ose agjencia e caktuar prej saj ka të drejtë nëpërmjet zëvendësimit për të ushtruar të drejta dhe përmbushur pretendimet e atyre investitorëve.

2. Të drejtat ose pretendimet e cenuara nuk tejkalojnë të drejtat dhe pretendimet e investitorit.

Neni 10 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve kontraktuese

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve kontraktuese në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje në masën që është e mundur zgjidhjet me rrugë diplomatike.

2. Nëse nuk është e mundur që marrëveshja të zgjidhet në këtë mënyrë brenda gjashtë muajve nga fillimi i bisedimeve, kjo me kërkesë të një prej të dyja palëve kontraktuese, i paraqitet gjykatës së arbitrazhit.

3. Gjykata e Arbitrazhit ngrihet në mënyrën e mëposhtme: secila palë kontraktuese cakton një arbitër dhe këta dy arbitra zgjedhin një shtetas të një vendi të tretë si kryetar. Arbitrat emërohen brenda tre muajve dhe kryetari brenda pesë muajve nga data në të cilën një prej palëve kontraktuese ka informuar palën tjetër kontraktuese për qëllimin e saj për t'ia paraqitur mosmarrëveshjen gjykatës së arbitrazhit.

4. Nëse brenda afateve të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni nuk janë bërë emërimet e nevojshme, secila prej palëve kontraktuese, në mungesë të një marrëveshjeje tjetër, fton kryetarin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të bëjë emërimet e nevojshme. Nëse kryetari është një shtetas i një pale kontraktuese ose nëse ai pengohet në përmbushjen e këtij funksioni, zëvendëskryetari ftohet të bëjë emërimet e zakonshme. Nëse zëvendëskryetari është shtetas i një pale kontraktuese ose edhe nëse ai pengohet në përmbushjen e këtij funksioni, anëtari i Gjykatës Ndërkombëtare që vjen pas tyre, i cili nuk është shtetas i një pale kontraktuese, ftohet të bëjë emërimet e nevojshme.

5. Kryetari i Gjykatës së Arbitrazhit është shtetas i një shteti të tretë me të cilin të dyja palët kontraktuese kanë marrëdhënie diplomatike.

6. Gjykata e Arbitrazhit e nxjerr vendimin e saj në pajtim me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, marrëveshjet e tjera përkatëse në fuqi ndërmjet palëve kontraktuese dhe rregullave të zbatueshme dhe parimeve të së drejtës ndërkombëtare.

7. Përveç kur palët kontraktuese vendosin ndryshe, Gjykata e Arbitrazhit vendos procedurën e vet.

8. Gjykata e Arbitrazhit e merr vendimin e saj me shumicë votash dhe ky vendim është përfundimtar dhe detyrues për të dyja palët kontraktuese.

9. Secila palë kontraktuese mbulon shpenzimet e arbitrit të vet dhe ato në lidhje me përfaqësimin në gjykimin në arbitrazh. Shpenzimet e tjera, duke përfshirë ato të kryetarit, mbulohen në pjesë të barabarta nga të dyja palët kontraktuese.

Neni 11

Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve kontraktuese dhe investitorëve të palës tjetër kontraktuese

1. Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet një prej palëve kontraktuese dhe një investitori të palës tjetër kontraktuese në lidhje me një investim në kuptimin e kësaj marrëveshjeje i njoftohen me shkrim, duke përfshirë një informacion të detajuar, nga një investitor i palës tjetër kontraktuese. Në masën që është e mundur, palët e interesuara përpiqen t'i zgjidhin mosmarrëveshjet me pajtim.

2. Nëse këto mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhen me pajtim brenda gjashtë muajve nga data e njoftimit me shkrim të përmendur në paragrafin 1, mosmarrëveshja mund t'i paraqitet, sipas zgjedhjes së investitorit:

- Gjykatës kompetente të palës kontraktuese në territorin e së cilës është bërë investimi; ose
- Institutit të Arbitrazhit të Gjykatës së Arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë në Stokholm; ose
- Gjykatës së Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris; ose
- Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve (ICSID) të themeluar me konventën e datës 18 mars 1965 për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të investimeve ndërmjet shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera.

3. Në rastin kur investitori vendos t'ia paraqesë mosmarrëveshjen arbitrazhit ndërkombëtar, secila palë kontraktuese jep pëlqimin për paraqitjen e kësaj mosmarrëveshjeje arbitrazhit ndërkombëtar.

4. Gjykata e Arbitrazhit e merr vendimin për mosmarrëveshjen në pajtim me dispozitat e kësaj marrëveshjeje dhe rregullat e zbatueshme, dhe parimet e së drejtës ndërkombëtare. Vendimet e arbitrazhit janë përfundimtare dhe detyruese për të dyja palët në mosmarrëveshje. Secila palë kontraktuese ekzekuton pa vonesë çdo vendim të tillë dhe ky vendim ekzekutohet në pajtim me ligjin e brendshëm.

5. Gjatë gjykimit në arbitrazh ose ekzekutimit të vendimit, një palë kontraktuese e përfshirë në mosmarrëveshje nuk ngre asnjë pretendim që investitori i palës tjetër kontraktuese ka marrë kompensim në bazë të një kontrate sigurimi në lidhje me të gjithë ose një pjesë të dëmit.

Neni 12

Dispozita të tjera

Një palë kontraktuese, në pajtim me ligjet, rregulloret dhe praktikat administrative të zbatuara të saj, shqyrton në mirëbesim kërkesat për hyrjen dhe qëndrimin e investitorëve, të punësuarve dhe punëtorëve të palës tjetër kontraktuese që janë përfshirë në aktivitetet në lidhje me investimet.

Neni 13

Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe përfundimi

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën në të cilën palët kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën që janë përmbushur formalitetet e tyre përkatëse kushtetuese të nevojshme për hyrjen në fuqi të



marrëveshjeve ndërkombëtare. Ajo mbetet në fuqi për një periudhë fillestare prej dhjetë vjetësh dhe rinovohet automatikisht për periudha pasuese dyvjeçare.

2. Kjo marrëveshje nuk cenon të drejtën e asnjë prej palëve kontraktuese për të ndryshuar plotësisht ose pjesërisht apo prishur këtë marrëveshje në çdo kohë gjatë periudhës së vlefshmërisë së saj.

3. Në një rast të tillë, nëse palët kontraktuese nuk arrijnë marrëveshje për një ndryshim ose prishjen e kësaj marrëveshjeje brenda gjashtë muajve pas kërkesës me shkrim të palës kontraktuese që kërkon këtë ndryshim ose prishje të marrëveshjes drejtuar palës tjetër kontraktuese, pala që ka bërë këtë kërkesë ka të drejtën të denoncojë të gjithë këtë marrëveshje brenda (30) ditëve nga skadimi i afatit të caktuar 6-mujor. Ky denoncim bëhet me rrugë diplomatike dhe konsiderohet si njoftim për prishjen e kësaj marrëveshjeje. Në një rast të tillë marrëveshja priset gjashtë muaj pas datës së marrjes së njoftimit përkatës nga pala tjetër kontraktuese, përveç kur ky njoftim tërhiqet me marrëveshje me shkrim para skadimit të kësaj periudhe njoftimi.

4. Në lidhje me investimet e bëra para datës së ndryshimit ose prishjes së kësaj marrëveshjeje, dispozitat e të gjitha neneve të tjera të kësaj marrëveshjeje vazhdojnë të mbeten në fuqi për një periudhë tjetër prej dhjetë vjetësh nga ajo datë.

Si dëshmi e kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Bërë në Nikosia, më 5.8.2010, në dy kopje origjinale, në gjuhët shqipe, greke dhe angleze dhe të gjitha tekstet janë njëllor të barasvlershme. Në rast mospërputhjeje në interpretim, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË QIPROS

Ilir Meta
ZËVENDËSMINISTRI DHE MINISTRI I
PUNËVE TË JASHTME

Markos Kyprianos
MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME

VENDIM

Nr.728, datë 20.10.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË NDËRTIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË PORTIT TË JAHTeve NË
SPILLE, KAVAJË, DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE
KONKURRUESE QË I JEPET BASHKIMIT TË SHOQËRIVE “ÇABEJ SHPK DHE ABG,
NDËRTIM SHPK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pikat 1 e 3, dhe 23, pika 3 shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion të ndërtimit dhe shfrytëzimit të Portit të Jahteve në Spille, Kavajë, është Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

2. Koncesioni të jetë i formës BOT (ndërtim, operim dhe transferim në pronësi të shtetit).
 3. Miratimin e bonusit prej 6.3% të pikëve për rezultatin teknik, financiar dhe mjedisor në procedurën për zgjedhëse konkurruese (propozim i pakërkuar) që i jepet bashkimit të shoqërive “Çabej sh.p.k. dhe ABG, ndërtim sh.p.k.”.
 4. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.731, datë 26.10.2011

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E ARSIMIT DHE SHKENCËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 16 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, në programin buxhetor 09230 “Arsimi i mesëm i përgjithshëm”, zëri “Shpenzime korente”, t’i shtohet fondi prej 46 000 000 (dyzet e gjashtë milionë) lekësh.
 2. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, në programin buxhetor 09240 “Arsimi profesional”, zëri “Shpenzime korente”, t’i shtohet fondi prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh.
 3. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, nga buxheti i miratuar për vitin 2011, në programin buxhetor 01110 “Planifikim menaxhim”, zëri “Shpenzime korente”, t’i zbritet fondi prej 79 000 000 (shtatëdhjetë e nëntë milionë) lekësh.
 4. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, nga buxheti i miratuar për vitin 2011, në programin buxhetor 09120 “Arsimi bazë”, zëri “Shpenzime korente”, t’i zbritet fondi prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh.
 5. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, nga buxheti i miratuar për vitin 2011, në programin buxhetor 09450 “Arsimi i lartë”, zëri “Shpenzime korente”, t’i zbritet fondi prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekësh.
 6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr.734, datë 26.10.2011

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË KOMUNËS MOGLICË, TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike, të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Moglicë, të qarkut të Korçës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 93 (nëntëdhjetë e tre) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 592 (pesëqind e nëntëdhjetë e dy).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Moglicë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Moglicë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
65	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative	Në pronësi
50-64	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
42-49	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive socialo-kulturore e sportive	Në pronësi
16-41	Varrezat publike	Në pronësi
1-15 (vetëm trojet e lira)	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
1-15 (vetëm sheshet) 486-494	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
495-510	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
418-420, 422-424, 426-428, 430-432, 434-436, 438, 439, 441-443, 445, 446, 448-450, 452-454, 456, 457, 459-461,	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim

463, 464, 466, 468-470, 472-474, 476-478, 480-482		
421, 425, 429, 433, 437, 440, 444, 447, 451, 455, 458, 462, 465, 467, 471, 475, 479, 483	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproductive dhe kanale të treta)	Në pronësi
538	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi

VENDIM

Nr.736, datë 26.10.2011

PËR ULJEN E TARIFËS SË QIRASË SË MJEDISEVE TË PALLATIT TË KONGRESEVE, PËR ORGANIZIMIN E PANAIRIT XIV TË LIBRIT “TIRANA 2011”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.9967, datë 24.7.2008 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr.4, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Uljen e tarifës së qirasë së mjediseve të Pallatit të Kongreseve në masën 25 (njëzet e pesë) për qind, për organizimin e panairit XIV, të librit “Tirana 2011”.
2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.737, datë 26.10.2011

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALEVE “VOKOPOLA 1” E “VOKOPOLA 2” DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, e 23 pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentraleve “Vokopola 1” e “Vokopola 2”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2% të pikëve për rezultatin, teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar) për dhënie me koncesion të këtyre hidrocentraleve, që i jepet shoqërisë “GERI - 01” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentraleve “Vokopola 1” dhe “Vokopola 2” të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtyre hidrocentraleve.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.738, datë 26.10.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALEVE MBI KASKADËN E LUMIT VJOSA, SI
PROPOZIM I KËRKUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, 9 e 16 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentraleve mbi kaskadën e lumit Vjosa, si propozim i kërkuar, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.739, datë 26.10.2011

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR
KRYEMINISTRINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryeministrisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, zëri “Shpenzime korente”, t’i shtohet fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve për shtesën e marrëveshjes së angazhimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe studios ligjore “Patton Boggs LTD”, lidhur më datë 12.7.2010, me nr.2711 prot.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Kryeministria për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.740, datë 26.10.2011

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË
Z. DRINI KARAGJOZI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, në zërin “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të z. Drini Karagjozi.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



KËRKESË
Nr.4508/3, datë 21.10.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga “Ndërtimi i linjave kryesore të dërgimit të sistemeve të kanalizimeve të ujërave të zeza të Lezhës dhe Shëngjinit për në ITUP-në e qytetit të Lezhës”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.872, datë 12.12.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.3.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik””, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit: tokë, arë.

Për pasuritë me pronar të paidentifikuar është bërë shënimi “I pakonfirmuar”, pasi nuk disponojmë konfirmim nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Lezhë. Personat të cilët pretendojnë pronësinë mbi këto pasuri duhet të aplikojnë për regjistrimin e tyre, në të kundërt nuk do të mund të kompensohen për efekt shpronësimi.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 881 680 (tetëqind e tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I OBJEKTIT “NDËRTIMI I LINJAVE KRYESORE TË DËRGIMIT TË SISTEMEVE TË KANALIZIMEVE TË UJËRAVE TË ZEZA TË LEZHËS DHE TË SHËNGJINIT PËR NË ITUP-NË E QYTETIT TË LEZHËS

Nr.	Pronari			ZK	Nr. pas.	Tokë arë			Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip. m²	Çmimi	Vlera në lekë	
	Fshati Ishull-Shëngjin, komuna Shëngjin Z.K.1987								
1	Paulin	Ndue	Gjergji	1987	14/7	450	428	192600	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Kol	Tom	Cali	1987	109/1	450	428	192600	
3	I paidentifikuar			1987	431	15	428	6420	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	I paidentifikuar			1987	442	260	428	111280	I pakonfirmuar
5	I paidentifikuar			1987	166	105	428	44940	I pakonfirmuar
6	I paidentifikuar			1987	60/94	200	428	85600	I pakonfirmuar
7	I paidentifikuar			1987	60/35	160	428	68480	I pakonfirmuar
8	I paidentifikuar			1987	60/145	210	428	89880	I pakonfirmuar
9	I paidentifikuar			1987	60/138	210	428	89880	I pakonfirmuar
		TOTALI				2060		881680	



KËRKESË
Nr.6464/1, datë 25.10.2011
PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shpall kërkesën për shpronësim, me interes publik, të pasurive të paluajtshme të tipit tokë: bujqësore, tokë truall, ndërtim, shtëpi banimi dhe “kulturave bujqësore” që preken nga “Ndërtimi dhe shfrytëzimi i linjës tregtare, me rrymë të vazhduar, të interkonjeksionit, Shqipëri-Itali”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është shoqëria “Interconnector Albania” sh.p.k., Tiranë. Me anën e këtij publikimi në shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë që dëmtohet dhe masën e kompensimit përkatës të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për secilin pronar sipas listës emërore të mëposhtme.

Brenda 15 ditëve nga data e fundit e publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës pranë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Nasip Naço

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS SË INTERKONJEKSIONIT ITALI - SHQIPËRI

Qarku Vlorë

Lloji i pasurisë që shpronësohet: tokë bujqësore

Lloji i pasurisë që dëmtohet për shkak të ndërtimit: kultura bujqësore, të mbjella

Nr.	Objekti	Shpronësim definitiv										Shpronësim provizor					Vlera totale (lekë)	Adresa e pronarit	Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Z.K	Nr. i pasurisë	Sip. e pasurisë (m ²)	Sip. shpronësim definitiv (m ²)	Çmimi lekë/m ²	Vlera e kompensimit (lekë)	Sasia në m ²	Lloji i kulturës	Vlera në lekë/kg	Sasia (Kv/Kg)	Vlera e kompensimit (lekë)			
1	Zgjerimi i nënstacionit elektrik te OST në Babicë	Novrus	Mahil	Likaj	Tokë arë	1060	320	10000	200.00	455.0	91,000.00	200.00	Jonxhë	20		4000	95,000.00	Babicë e Madhe	Për zonën kadastrale të fshatit Babicë nuk është kryer regjistrimi fillestar sistematik
2	Zgjerimi i nënstacionit elektrik te OST në Babicë	Ali	Selim	Selimi	Ullishte	1060	323 / 7	6600	600.00	455.0	273,000.00	600.00	Pemëtores	200		120000	393,000.00	Babicë e Madhe	Për zonën kadastrale të fshatit Babicë nuk është kryer regjistrimi fillestar sistematik
3	Shtylla e tensionit të lartë	Refat	Adem	Bejto	Ullishte	1060	34 / 2 / 1	1800	50.00	455.0	22,750.00	50.00	Ullishte	200		10000	32,750.00	Babicë e Madhe	Për zonën kadastrale të fshatit Babicë nuk është kryer regjistrimi fillestar sistematik
4	Shtylla e tensionit të lartë	Fejzo	Myzafer	Maraj	Ullishte	1060	76 / 10	7000	50.00	455.0	22,750.00	50.00	Ullishte	200		10000	32,750.00	Vlorë	Për zonën kadastrale të fshatit Babicë nuk është kryer regjistrimi fillestar sistematik
5	Shtylla e tensionit të lartë	Gezim	Isuf	Hyseni	Ullishte	1060	76 / 2	1000	50.00	455.0	22,750.00	50.00	Ullishte	200		10000	32,750.00	Vlorë	Për zonën kadastrale të fshatit Babicë nuk është kryer regjistrimi fillestar sistematik
6	Shtylla e tensionit të lartë	Hamza	Haredin	Dine	Tokë Arë	1060	119 / 7	5700	50.00	455.0	22,750.00	50.00	Foragjere	20		1000	23,750.00	Babicë e Madhe	Për zonën kadastrale të fshatit Babicë nuk është kryer regjistrimi fillestar sistematik
7	Shtylla e tensionit të lartë	Ormen	Selman	Çelaj	Toke Are	1060	342	6600	50.00	455.0	22,750.00	50.00	E pambjellë	1		50	22,800.00	Kaninë	Për zonën kadastrale të fshatit Babicë nuk është kryer regjistrimi fillestar sistematik

Shuma në m²: 1050.00

Shuma në lekë: 543,550.00

Shoqëria “Interconnector Albania” sh.p.k.



KËRKESË
Nr.5379/5, datë 25.10.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shpall kërkesën për shpronësim, me interes publik, të pasurive të paluajtshme të tipit: tokë bujqësore, tokë truall, ndërtim, shtëpi banimi dhe “kulturave bujqësore” që preken nga “Ndërtimi i linjës ajrore të tensionit të lartë të parkut eolik”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k., Tiranë. Me anën e këtij publikimi në shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë që dëmtohet dhe masën e kompensimit përkatës të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për secilin pronar sipas listës emërore të mëposhtme.

Brenda 15 ditëve nga data e fundit e publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës pranë komisionit të posaçëm të shpronësimit.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Nasip Naço

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS AJRORE TË TENSIONIT TË LARTË TË PARKUT EOLIK

Qarku Vlorë

Lloji i pasurisë që shpronësohet: tokë bujqësorë

Lloji i pasurisë që dëmtohet për shkak të ndërtimit: kultura bujqësore, të mbjella

Nr.	Objekti	Shpronësim definitiv										Shpronësim provizor					Vlera totale (lekë)	Adresa e pronarit	Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i Pasurisë	Z.K	Nr. i pasurisë	Sip. e pasurisë (m ²)	Sip. shpronësim definitiv (m ²)	Cmimi lekë/m ²	Vlera e kompensimit (Lekë)	Sasia në m ²	Lloji i kulturës	Vlera lekë/kg	Sasia (Kv/Kg)	Vlera e kompensimit (lekë)			
1	Shtylla e tensionit të lartë	Gjolek	Memisha	Merkaç	Ullishte	2074	718 / 1	10000	50.00	430	21,500.00	50.00	Ullishte	200		10000	31,500.00	Kanine	Për zonën kadastrale të fshatit Kaninë nuk është kryer regjistrimi fillestar sistematik
2	Shtylla e tensionit të lartë	Nadile	Xhezair	Xhezairaj	Ullishte	2074	371	5000	50.00	430	21,500.00	50.00	Ullishte	200		10000	31,500.00	Kanine	Për zonën kadastrale të fshatit Kaninë nuk është kryer regjistrimi fillestar sistematik, si dhe trashëgimtarët nuk bien dakord për ndjekjen e procedurave
3	Shtylla e tensionit të lartë	Resul	Haxhi	Muçaj	Ullishte	2074	152 / 1	5200	50.00	430	21,500.00	50.00	Ullishte	200		10000	31,500.00	Vlore	Për zonën kadastrale të fshatit Kaninë nuk është kryer regjistrimi fillestar sistematik
4	Shtylla e tensionit të lartë	Hasan	Azbi	Sinaj	Pemtores	1060	311 / 3 / 1	2800	50.00	455.0	22,750.00	50.00	Ullishte	200		10000	32,750.00	Babice e Madhe	Për zonën Kadastrale të fshatit Babice nuk është kryer regjistrimi fillestar sistematik

Shuma në m²: 200.00

Shuma në lekë: 127,250.00

Shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k.



KËRKESË
Nr.882/5, datë 26.10.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Bulqizë-Ura e Cerenecit.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.872, datë 12.12.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.3.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, lidhur me llojin e pasurisë tokë. Objekti është vlerësuar në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.3.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Pronarët për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është prej 3 690 482 (tre milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e dy) lekësh.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA (SHITESË) E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
“BULQIZË - URA E ÇERENECIT” LOTET I, II, III

Qarku: Dibër

Fshatrat: Vajkal, Dragu, Fushë-Bulqizë dhe Krajë

Nr	EMRI	ATESIA	MBIEMERI	ZONA KADAS.	NR. PASUR.	LLOJI I PASURISE								SHUMA LEKE	GJENDJA JURIDIKE NGA Z.V.R.P.P
						Are M²	Çmimi Leke	Vlera Leke	Truall M²	Çmimi Leke	Vlera Leke	Objekt VL.(Leke)	K. Buj.Drufr. VL.(Leke)		
1	MUSTAFA	BILAL	SULA	3694	767/6	90	197	17730						17730	KONFIRMUAR
2	SHKELQIM	ABDULLA	GJIMI	1660	1	1284	122	156648						156648	KONFIRMUAR
3	RABIE	ABDULLA	ZENELI	1660	2	128	122	15616						15616	KONFIRMUAR
4	TAHIR	RAMADAN	KICA	1660	130	98	122	11956						11956	KONFIRMUAR
5	TAHIR	RAMADAN	KICA	1660	94	172	122	20984						20984	KONFIRMUAR
6	TAHIR	RAMADAN	KICA	1660	95	83	122	10126						10126	KONFIRMUAR
7	TAHIR	RAMADAN	KICA	1660	9	220	122	26840						26840	KONFIRMUAR
8	TAHIR	RAMADAN	KICA	1660	50	233	122	28426						28426	KONFIRMUAR
9	MEHDI	SHERIF	KICA	1660	51	132	122	16104						16104	KONFIRMUAR
10	ESAT	MURAT	KICA	1660	69	64	122	7808						7808	KONFIRMUAR
11	LAVDIE	ALI	DISHA	1660	1477	279	122	34038						34038	KONFIRMUAR
13	SINAN	MEHMET	ALLIU	1660	733	144	122	17568						17568	KONFIRMUAR
12	ISUF	RAHMAN	BALA	1660	735	253	122	30866						30866	KONFIRMUAR
14	AGIM	MUHAREM	KURCANI	2262	111/13	245	246	60270						60270	KONFIRMUAR
15	DILAVER	BAJRAM	MERA	2262	29/3	170	246	41820					56170	97990	KONFIRMUAR
16	MUHAREM	ALI	MERA	2262	112/3								68565	68565	KONFIRMUAR
17	BEQIR	RAMADAN	DERVISHI	2262	38/1								550603	550603	KONFIRMUAR
18	MENTOR	HALIT	BOBA	1532	519				98	334	32732	2485612		2518344	KONFIRMUAR
	TOTALI	(LEKE)				3595		496800	98		32732	2485612	675338	3690482	

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 19.11.2011
Doli nga shtypi më 21.11.2011

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Mediaprint
Tiranë, 2011

Çmimi 50 lekë